



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:079850

Datë: 06.06.2022

Numri i dokumentit: 03100891

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1/2008

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda (në Objektivin e kësaj Gjykate në Veri), Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët; Mentor Hajraj dhe Gëzim Ademi, procesmbajtësja Edita Kelmendi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.M, i akuzuar për veprën penale; Kontrabandimi me migrantë nga neni 138 par.1 sipas Kodit Penal të Kosovës, e ri- kualifikuar në veprën penale; Kontrabandimi me migrantë nga neni 164 paragrafi 1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr.2/2008 të dt.02.01.2008 të cilën tani e përfaqëson Prokuroria Themelore në Mitrovicë. Shqyrtimi gjyqësor ka qenë i mbyllur për publikun për shkak të pandemisë COVID-19, rrjedha e shqyrtimit gjyqësor është regjistruar në procesverbal në mungesë të pajisjeve audio dhe video incizim. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prezencë të palëve, Prokurorit të shtetit në PTH-Mitrovicë, Naim Beka, të pandehurit E.M, mbrojtësit të tij, av.Xhafer Maliqi, në mungesë të dëmtuarve. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më datën 22.03.2022, më datën 24.03.2022, Gjykata ka shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa më dt.03.06.2022, është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

E.M me nofkën “.....” nga i ati, e ëma, i lindur më dt..... në V....., ku edhe jeton në Rr.....nr.00, përkohësisht me vendbanim në B.M –, F....., Rr....., –, ka të kryer fakultetin e Pedagogjisë në Prishtinë, i martuar – baba i tre fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, punon në një kompani si bashkëpronar me producent filmi, i njëjti;

SHPALLËT FAJTOR

Sepse:

Në periudhën kohore nga muaji janar i vitit 2006 e gjer më dt.03.03.2006, është marrë me kontrabandim të imigrantëve, në atë mënyrë që të dëmtuarve E....., E....., D..... e G..... Z..... të gjithë nga V....., shtetas të Kosovës, iu ka siguruar pasaporta të falsifikuara të Danimarkës, pastaj, sipas marrëveshjes i pandehuri ka marr përsipër të organizoj transportin e tyre për në Mbretërinë e Bashkuar. Udhëtimi dhe transporti i të dëmtuarve ishte planifikuar të realizohej përmes portit të Barit në Malin e Zi në Itali dhe prej aty për në Londër, krejt në mënyrë të kundërligjshme sepse të dëmtuarit nuk i plotësonin kushtet ligjore për të hyrje, kalim apo qëndrim në shtetet përkatëse. Të gjitha këto veprimi i pandehuri i ka ndërmarr me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë pasurore për vete, pasi që të dëmtuarit për këto shërbime i detyroheshin të pandehurit t'i paguanin shumën prej 8000 (tetëmijë) euro, si fillim ata kanë paguar shumën prej 3000 (tremijë) euro, ndërsa pjesën tjetër është dashur t'ia paguajnë pasi që të mbërrijnë në Angli. Mirëpo të dëmtuarit nuk kanë arrit që të shkojnë në Mbretërinë e Bashkuar, sepse janë ndaluar nga policia në portin e Barit në Mal të Zi, duke hyrë në traget me pasaporta të falsifikuara për të udhëtuar për në Itali, ku edhe janë ndaluar edhe paraburgosur.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës [KPRK].

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 par.1 pika 1.2, dhe nenin 164 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365, 366 të KPP-së, të pandehurit, i;

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej 3 (tri) viteve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale të natyrës së njëjtë apo të natyrës më të rëndë, në të kundërtën dënimi ekzekutohet, DHE
- II. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 10,000 (dhjetëmijë) euro, i cili EKZEKUTOHET si dhe obligohet i pandehuri ta paguaj brenda afatit prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë zëvendësohet me dënim me burgim,

siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në dënimin me gjobë të pandehurit i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 01.01.2008 e deri më dt.04.02.2008.

- III. OBLIGOHET i pandehuri E.M, që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro për taksën në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumën prej 80 (tetëdhjetë) euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykim.
- IV. HIQET DORËZANIA ashtu që të pandehurit E.M me të dhënat personale si më lartë, i kthehet shuma e parave të lënë në dorëzani prej; 7,000 € (shtatë mijë) euro. Paratë nga dorëzania i kthehet të pandehurit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe pasi të ketë paguar dënimin me gjobë si në pikën II në këtë aktgjykim. Shuma e dorëzansisë me pëlqimin e të pandehurit mund të bartet për të paguar dënimin me gjobë i shqiptuar kundër tij. OBLIGOHET Zyra e Financave pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të zbatojë pikën IV në këtë aktgjykim.
- V. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

- Aktakuza:

Më 2 janar 2008, Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.2/2008, kundër të pandehurit E.M për veprën penale; Kontrabandimi me migrantë nga neni 138 par.1 sipas Kodit Penal të Kosovës.

Më 25 janar 2008, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, sipas aktvendimit P.nr.1/2008 e ka konfirmuar aktakuzën ndaj të pandehurit E.M, kështu aktakuza ka marr formën e prerë.

- Kompetenca gjykatës për të shqyrtuar rastin:

Sipas nenit 1 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale ka ndodhur në regjionin e Mitrovicës – Vushtrrisë, dhe rrjedhimisht, bien brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29 paragrafi 1 të KPP-së. Sipas nenit 22 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.45 të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale: Kontrabandimi me migrantë, hynë në juridiksionin e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, e tërë lënda është gjykuar nga ky departament.

- Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor;

Seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale janë mbajtur më datat 14.12.2021, 28.01.2022 dhe 22.03.2022. Shqyrtimi gjyqësor kanë qenë i mbyllur për publikun, sipas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të palëve dhe të publikut, duke pasur parasysh gjendjen epidemiologjike me pandeminë COVID-19, me përjashtim të mediave të cilat kanë qenë prezent dhe janë lejuar të marrin pjesë sipas këtij vendimi. Palët nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje lidhur me këtë vendim.

- Gjuha në të cilën është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor;

Shqyrtimit gjyqësor është mbajtur në gjuhën shqipe.

- Regjistrimi i seancave të shqyrtimit gjyqësor;

Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është regjistruar në procesverbal. Palët s'kanë paraqitur asnjë vërejtje në përmbajtjet e procesverbalit. Pas përfundimit të seancave të shqyrtimit gjyqësor, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit, ashtu siç kërkohet me ligj. Seancat e shqyrtimit gjyqësor nuk janë regjistruar me audio dhe video, për shkak se kanë munguar pajisjet e nevojshme për incizime të tilla, por regjistrimi është bërë në procesverbal me shkrim.

- Prezenca e palëve në shqyrtimin gjyqësor;

Në shqyrtimin gjyqësor kanë prezantuar; Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë, Naim Beka i pandehuri E.M, mbrojtësit i tij, av.Xhafer Maliqi, ndërsa kanë munguar të dëmtuarit.

Gjykata ka bërë përpjekje për t'i ftuar të dëmtuarit E..... dhe E Z.....,për të marr pjesë në shqyrtimin gjyqësor, megjithatë kjo nuk ka pasur sukses. Sipas dëshmime (fletë-kthesave) dhe

raporteve policore, rrjedh se të dëmtuarit nuk jetojnë në adresat e banimit të lajmëruara, por gjenden diku në Evropë e që nuk është arrit që të sigurohet adresa e tyre.

- Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor;

Në cilësi të provave janë administruar provat e propozuar nga prokuroria e shtetit në PTH në Mitrovicë, sipas aktakuzës.

Më 14 dhjetor 2021 në shqyrtimin gjyqësor, janë dëgjuar dëshmitarët A.I dhe R.K, dëshmitar të prokurorisë.

Më 22 mars 2022 në shqyrtimin gjyqësor, është dëgjuar dëshmitari B.LI, dëshmitar i prokurorisë.

Më 28 janar 2022 në shqyrtimin gjyqësor, sipas propozimit të prokurorit dhe në mbështetje të nenit 338 par.1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penal [KPP], Gjykata ka vendosur që vetëm t'i lexoj deklaratat e E.M dhe F.M. Gjykata në shqyrtimin gjyqësor nuk ka arrit të sigurojë prezencën e tyre, pasi që në bazë te njoftimeve është vërtetuar se të njëjtit nuk jetojnë më (kanë ndërruar jetë).

Në shqyrtimin gjyqësor, më 22 mars 2022 duke u bazuar në nenin 338 par.1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penal [KPP], Gjykata ka vendosur vetëm t'i lexoj deklaratat e dëshmitarëve; E.Z dhe A.M, pasi që, përkundër përpjekjeve në shqyrtimin gjyqësor s'është arrit të sigurohen këta dëshmitar. Në raport me dëshmitarin E.Z në pamundësisë për dorëzimin e thirrjes për shqyrtimin gjyqësor, shkaku i mungesë së adresës apo të dhënave mbi vendbanimin e tij. Për dëshmitarin A.M për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk ka marr pjesë në shqyrtim gjyqësor.

- Provat materiale të administruara;

- aktvendimi i Gjykatës Themelore në Bari të Malit të Zi, P.nr.186/06 dt.06.04.2006.
- aktvendimi i të njëjtës Gjykatë HEP nr.50/06 dt.08.03.2006 dhe Kri.Nr.94/06 dt.06.03.2006 dhe KP nr.105/06 dt.13.04.2006.

- Fjala përfundimtare e palëve;

Më 22 mars 2022, prokurori Naim Beka, në fjalën përfundimtare ka deklaruar; mbetet panë aktakuzës se ngritur, duke besuar se gjatë administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, dëshmohet që i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas tij, kryerja e veprës, provohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, R.K, A.M, pastaj edhe nga deklaratat e lexuar në shqyrtim gjyqësor që në mënyrë të pa kontestuar dëshmohet se i pandehuri ka kryer veprën penale. Më tej shton se, sa i përket dëshmitarit B.LI, gjykata duhet t'i jep besimin deklaratës së dhënë në polici, për faktin se ajo është një deklaratë më e freskët edhe në lidhshmëri me provat tjera, e veçanërisht me deklaratën e dëshmitarit E.Z, ku nuk është kontestuese se E.Z kishte kontaktuar me dëshmitarin B.LI, pastaj nga deklarata e E.Z, rezulton se B.LI, të njëjtit ia kishte kthyer 3000 euro më dt.09.02.2006, por nuk ja kishte kthyer tërë për lartësinë e dëmit që i kishte shkaktuar. Faktin se i akuzuari E.M kishte manifestuar veprimet inkriminuese të përshkruar si në dispozitiv të akuzës, provohet edhe nga fakti se në Bari të Malit të Zi, janë zhvilluar hetimet ndaj E.Z dhe E.Z, në drejtim të veprave penale falsifikim i dokumenteve, dokumente këto që ishin siguruar nga i akuzuari edhe pse i njëjti iu kishte premtuar se do të jenë origjinale. Për më tepër, mbetet të theksohet edhe një aspekt që thekson i dëmtuari, dëshmitari E.Z, ku përveç tjerash ka deklaruar “kemi arrit të dalim në Malin e Zi, kemi bujtë një natë të nesërmen kemi arrit të shkojmë te trajekti, E..... më ka thënë të hyjë i pari me fëmijë e unë hyjë mbas teje, e sa i përket pasaportave ia ka sugjeruar që të mos ia përmendin emrin e tij”. Prokurori ka propozuar Gjykatës që ta shpall fajtor të pandehurin dhe t'i ketë parasysh rrethanat lehtësues dhe rënduese, si rrethana lehtësues korrektësinë e të pandehurit, të merre parasysh se ka kaluar një kohën e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, si rrethana rënduese, se këto vepra paraqesin rrezik për shoqërinë dhe gjithmonë janë me probabilitet që gjatë kontrabandimit të dëmtuarit duhet të ballafaqohen me situata të ndryshme me rrezikun që mund të iu kanoset.

Në shqyrtimin gjyqësor, më 22 mars 2022, av.Xhafer Maliqi ka paraqitur fjalën përfundimtare. Sipas mbrojtësit, provat e akuzës nuk janë në harmoni me Kodin e Procedurës Penale. Për më tepër, provat të cilat gjykata i pranoj duke i trajtuar si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të shërbejnë si bazë për ndonjë aktgjykim dhe në asnjë mënyrë për aktgjykim dënues. Duke shtuar se, në rastin konkret i pandehuri duhet të lirohet nga akuza në mungesë të provave të besueshme dhe proceduralisht të vlefshme për të mbështetur një aktgjykim dënues.

I pandehuri E.M në tërësi e ka përkrah fjalën përfundimtare që e ka paraqitur mbrojtësit i tij, mirëpo ai nuk ka paraqit fjalën e tij përfundimtare, përkundër që iu ka dhënë kjo mundësi gjatë shqyrtimit gjyqësor.

- Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor dhe shpallja publik e aktgjykimit:

Më 22 mars 2022, Gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa, më 24 mars 2022, Gjykata ka shpall publikisht aktgjykimi, në prezencën e të pandehurit E.M dhe në mungesë të mbrojtësit av.Xhafer Maliqi si dhe të prokurorit të rastit Naim Beka.

Aktgjykimi në këtë rast nuk është arrit të përpilohet me shkrim në afatin ligjor. Kryetari i Trupit Gjyqësor, ka kërkuar nga Kryetari/ja i Gjykatës, lejimin e vazhdimit të afatit për përpilimin e aktgjykimit. Kryetari/ja i Gjykatës, sipas aktvendimit, GJA.nr.7/2022 të datës 22.04.2022 ka lejuar vazhdimin e afatit për përpilimin e aktgjykimit edhe për (60) gjashtëdhjetë ditë nga dita e përfundimit të afatit ligjor për përpilimin e aktgjykimit, për shkak të arsyeve objektive të pamundësisë në përpilimin në kohë të aktgjykimit me shkrim.

- Mbrojta e të pandehurve:

I pandehuri E.M nuk kanë paraqitur mbrojtjen për këtë rast dhe në konsultim me mbrojtësin e tij, ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje.

I pandehuri që nga fillimi i procedurës penale por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjetjet e Gjykatës;

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vërtetuar se i pandehuri gjatë muajit janar të vitit 2006 në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të përfitimit të dobisë material për vete, ka siguruar dy pasaporta të falsifikuara Daneze për të dëmtuarit E..... e E..... Z..... dhe dy fëmijët e tyre. I pandehuri i ka siguruar këto dy pasaporta me qëllim që t'i dërgojë të dëmtuarit në mënyrë të kundërligjshëm në Mbretërinë e Bashkuar (Angli).

Gjykata faktet e lartcekura i ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit E.Z, dëshmitë e dëshmitarëve, B.LI, A.I, B.LI dhe A.M.

I dëmtuari E.Z në deklaratën e tij që ka dhënë më dt.11.10.2006 për këto rrethana ka deklaruar; “Unë dhe bashkëshortja ime E..... dhe dy fëmijët tanë, D..... dhe G..... Z....., kemi qenë të interesuar të shkojmë në Angli. Për këtë qëllim, përmes personit R.K, jemi takuar në Vushtrri me E.M. Në këtë takim kanë qenë prezent babai imë B...., A..... dhe E.M. Unë i tregova që jam i interesuar që të shkoj në Angli, por që s’kemi pasaporta. E..... me tha; *unë t’i siguroj pasaporta origjinale që kushtojnë 8000 (tetëmijë) euro me udhëtim deri në Angli*, pra, dy pasaporta timin dhe bashkëshortes që kanë qenë të vendosur dy fotografitë e fëmijëve. Unë e kam pranuar këtë marrëveshje dhe pas dy jave ia kam paguar E..... shumën prej 3000 euro, ndërsa jemi dakorduar që pjesën tjetër të parave t’ia paguaj pasi që të mbërrijmë në Angli. E....., pasaportat mi ka sjellë në shtëpi në muajin janar 2006, kanë qenë pasaporta Daneze.

Dëshmitari A.I në dëshminë e tij që ka dhënë më dt.26.10.2006 lidhur me këto rrethanë ka deklaruar; Në kafiterin e F.M në V....., kam shkuar aty dhe kanë qenë prezent B.Z me të birin e tij, E....., dhe E..... që jeton dhe punon në Angli si dhe pronari i kafes F.M. Aty është biseduar dhe janë marr vesh që E..... t’i rregullojë dy viza për E..... dhe bashkëshorten e tij dhe për dy fëmijët e tyre. Sipas marrëveshjes, atë ditë E.... ia ka paguar 3000 (tremijë) euro si dhe ia ka dhënë fotografitë për pasaporta. Janë dakorduar që pjesa tjetër e parave t’i paguhet E....., kur këta të mbërrijnë në Angli. Aty është thënë se udhëtimi do të bëhet nga Aeroportit i Prishtinës dhe direkt në Angli.

Dëshmitari A.M në dëshminë e tij që ka dhënë më dt.26.10.2006 lidhur me këto rrethanë ka deklaruar; Kam qenë në kafiteri/kuzhinë dhe ka ardh një kamerier më ka thirr, kur kam dal ka qenë E....., B..... dhe djali i tij. B.Z ka kërkuar që unë të jem garantues në një marrëveshje për vëllain tim E..... (E.M). Në atë takim, B..... me ka thënë se a ’ka garanci që vëllai i juaj E....., të ma dërgon djalin tim jashtë vendit. Unë i kam thënë, jo për E..... por për askënd nuk mund të garantojë.

Dëshmitari B.Ll në dëshminë e tij që ka dhënë më dt.11.08.2006 në pyetjen e parashtruar nga zyrtaret policor, pyetja; Çka kanë biseduar E..... me E..... kur ti ke qenë prezent në depon e E.....? Dëshmitari është përgjigjur; E..... i ka propozuar që të udhëtonin përmes Barit dhe ashtu edhe është vendosur.

Se i pandehuri iu ka siguruar të dëmtuarve pasaporta të falsifikuara, ky fakt vërtetohet edhe me prova tjera, siç janë; aktvendimi i Gjykatës Themelore në Bari të Malit të Zi, P.nr.186/06 dt.06.04.2006, aktvendimi i të njëjtës Gjykatë, HEP nr.50/06 dt.08.03.2006 dhe Kri.Nr.94/06 dt.06.03.2006 dhe KP nr.105/06 dt.13.04.2006. Sipas këtyre dy vendimeve konstatohet se të dëmtuarit E....., E.Z..... dhe dy fëmijët e tyre D..... dhe G.Z..... janë ndaluar nga policia e Malit të Zi, duke tentuar të udhëtonin me dokumente jo të rregullta (falsifikuara) me tragetin e udhëtarëve në “Sveti Stefan” në linjën e trafikut uJOR, Bari-Bar.

Andaj, Gjykata faktet e lartcekura i merr të vërtetuar përtej çdo dyshimi, pasi që të gjitha provat tregojnë për një gjendje të tillë të fakteve që janë vërtetuar më lart.

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri E.M në mars të vitit 2006 pasi që të dëmtuarit E..... dhe E..... Z.....i ka pajisë me dokumente të falsifikuara të udhëtimit-pasaporta Daneze, pastaj në mënyrë të kundërligjshme të dëmtuarit i ka transportuar nga Kosova për në Serbi. I pandehuri ka organizuar transportin e tyre deri në Barit në Mal të Zi, me qëllim që të udhëtojnë me tragetin e udhëtarëve në linjën e trafikut uJOR, Bari – Bar, Itali dhe nga aty për në Mbretërinë e Bashkuar, mirëpo të dëmtuarit ndalohen nga policia malazeze në hyrje të tragetit pasi konstatohet që dokumentet (pasaportat) me të cilat po udhëtonin kanë qenë të falsifikuara.

- Se i pandehuri ka marr përsipër organizimin dhe sigurimin e transportit për t’i dërguar të dëmtuarit në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykata këtë fakt e ka vërtetuar në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve tjerë në këtë rast, të cilët dëshmojnë se i pandehuri u ka premtuar të dëmtuarve se do t’i dërgonte në Angli. Për këtë qëllim i pandehuri së bashku me të dëmtuarit ka udhëtuar nga Kosova në Serbi, pastaj në Mal të Zi, dhe prej aty deri në portin e Barit. I pandehuri gjatë gjithë kohës i ka shoqëruar të dëmtuarit duke ju dhënë udhëzime dhe sugjerime për rrugën që do ta përshkonin, pa përjashtuar veprimet tjera të e tij, rreth organizimit të udhëtimit për të dëmtuarit për në portin e Barit.

Lidhur me këtë rrethanë i dëmtuari ka deklaruar; “Unë i tregova që jam i interesuar që të shkoj në Angli, por që s’kemi pasaporta. Atëherë E.....me tha; ***unë t’i siguroj pasaporta origjinale që kushtojnë 8000 (tetëmijë) euro me udhëtim deri në Angli.*** Pasi i kam marr pasaportat unë, gruaja dhe dy fëmijët e mijë jemi nisë me qëllim që të shkojmë në perëndim. Deri në Zveçan na ka dërgua babi im, pastaj E..... e ka organizuar pjesën tjetër të transportit apo udhëtimit. Ka

ardhur një automjet aty na ka marr dhe kemi udhëtuar deri në Beograd në hotelin Jugosllavia. Aty e kemi takuar E..... Nga aty jemi kthyer në Krlev në hotelin Matarushka, Banjë. Aty kemi qëndrua dymbëdhjetë ditë dhe nuk kemi arrit të udhëtojmë, jemi kthye në shtëpi. Më datën 5 mars, prapë jemi nisë për në Bari në Mal të Zi, unë, bashkëshortja dhe fëmijët, ku prindi im B..... ka vozitë por krejt organizmi ka qenë i E..... Kemi arrit në Bari, kemi qëndruar aty një natë dhe të nesërmen kemi shkuar për në traget, E..... ka qenë aty dhe me tha, ti me fëmijët hyni të parët e unë pas juve, nëse të thonë diçka për pasaporta s'kanë çfarë të bëjnë, po mos ma përmend emrin mua. Policia na ndalojë me thanë se pasaportat janë të falsifikuara dhe aty na ndaluan pastaj na dërguan në burg”.

Ndërsa, dëshmitari B.Ll në dëshminë e tij, që ka dhënë më dt.11.08.2006 në pyetjen e parashtruar nga zyrtaret policor, pyetja; Çka kanë biseduar E..... me E..... kur ti ke qenë prezent në depon e E.....? *Dëshmitari është përgjigjur; E..... i ka propozuar që të udhëtonin përmes Barit dhe ashtu edhe është vendosur.*

Dëshmitari A.I për këtë rrethanë ka deklaruar; “Në takimin që kam qenë unë, aty është biseduar dhe janë pajtuar që E..... t’ia rregullojë dy viza për E.... (E.Z) bashkëshorten dhe dy fëmijët tij. Për këtë E..... ka paguar 3000 (tremijë) euro po atë ditë, pastaj ia ka dhënë edhe fotografitë për pasaporta. Janë dakorduar që pjesa tjetër e parave t’i paguhet E....., kur këta të mbërrijnë në Angli. *Aty është thënë se udhëtimi do të bëhet përmes Aeroportit në Prishtinë dhe direkt në Angli.*

- Se i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka organizuar transportin e të dëmtuarve nga Kosova- Serbi, pastaj në Malin e Zi, Bari, ky fakt vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarit E.Z, si dhe dëshmitarët B.Ll, A.I. Të gjithë këta dëshmitar pohojnë faktin se i pandehuri ka marr përsipër jo vetëm sigurimin e pasaportave (Daneze) për të dëmtuarit por edhe organizimin dhe transportin e tyre nga Kosova për në Mbretërinë e Bashkuar (Angli).

I pandehuri që nga fillimi ka marr për obligim që të dëmtuarit t’i pajisë me pasaporta pastaj edhe të organizoj transportin e tyre për në Evropë. Ai i ka shoqëruar gjatë gjithë kohës të dëmtuarit derisa kanë udhëtuar në Serbi, Beograd, pastaj me sugjerimin e tij, të dëmtuarit kanë qëndruar disa ditë në Krlevë. Në fund, sipas propozimit dhe me organizimin e të pandehurit, të dëmtuarit kanë udhëtuar nga Kosova drejtë Barit në Malin e Zi, që synonin të udhëtonin në Itali dhe pastaj në Mbretërinë e Bashkuar.

I dëmtuari ka thënë se, i pandehuri ka marr përsipër organizmin dhe transportin e tyre për në Angli. Dëshmitari A.I ka deklaruar se marrëveshja ka qenë për t'i siguruar pasaportat për të dëmtuarit dhe *udhëtimi do të bëhet përmes Aeroportit në Prishtinë dhe direkt në Angli*. Dëshmitari B.LI në dëshminë e tij ka thënë se; *E..... i ka propozuar E..... që të udhëtonin përmes Barit dhe ashtu edhe është vendosur*.

Gjykata si përfundim gjen se i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka planifikuar, organizuar dhe ka marr përsipër sigurimin e udhëtimit dhe transportin e të dëmtuarve nga Kosova për në Mbretërinë e Bashkuar. I pandehuri ka organizuar udhëtimin (transportin) e të dëmtuarve ashtu që me pasaporta të falsifikuara të dëmtuarit kanë udhëtuar nga Kosova në Malin e Zi, në portin ujor të Barit me qëllim që të udhëtojnë drejt Italisë dhe pastaj në Mbretërinë e Bashkuar. Fillimisht udhëtimi ishte planifikuar nga Prishtina me aeroplan, pastaj ka ndërruar plani dhe udhëtimi është tentuar të bëhet përmes Malit të Zi- Itali e tutje.

Se të dëmtuarit janë ndaluar nga policia e Malit të Zi në tragetin e udhëtarëve në “Sveti Stefan” në linjën e trafikut ujor, Bari-Bar duke tentuar që të udhëtojnë në mënyrë të kundërligjshme me pasaporta të falsifikuara për në Itali, Gjykata këto fakte i ka vërtetuar duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Themelore në Bari të Malit të Zi, P.nr.186/06 dt.06.04.2006, aktvendimi i të njëjtës Gjykatë, HEP nr.50/06 dt.08.03.2006 dhe Kri.Nr.94/06 dt.06.03.2006 dhe KP nr.105/06 dt.13.04.2006.

Gjithashtu edhe i dëmtuari E.Z pohon faktin se kanë marr rrugën për të udhëtuar për në Malin e Zi, gjersa kanë qenë duke hipur në traget për të udhëtuar nga Bari për në Itali, janë ndaluar nga policia për shkak se pasaportat me të cilat udhëtonin ishin të falsifikuara.

Sipas këtyre provave, rrjedhë se të dëmtuarit ishin ndaluar dhe burgosur në Malin e Zi, sepse kanë tentuar që me dokumente të falsifikuara të udhëtojnë në linjën e trafikut ujor, Bari-Bar-Itali.

Se i pandehuri ka kërkuar dhe pranuar para nga të dëmtuarit për t'i dërguar nga Kosova për në Angli, Gjykata këtë fakt e ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit E.Z dhe dëshmitarët tjerë në këtë rast. I dëmtuari për këtë rrethanë ka deklaruar; *“Unë i tregova që jam i interesuar që të shkoj në Angli, por që s’kemi pasaporta. E..... me tha; unë t’i siguroj pasaporta origjinale që kushtojnë 8000 (tetëmijë) euro me udhëtim deri në Angli. Unë e kam pranuar këtë marrëveshje*

dhe pas dy jave ia kam paguar E..... shumën prej 3000 euro, ndërsa jemi dakorduar që pjesën tjetër të parave t'ia paguaj pasi që të mbërrijmë në Angli”.

Dëshmitari A.I në deklaratën në polici për këtë rrethanë ka deklaruar “Në takimin që kam qenë unë, aty është biseduar dhe janë pajtuar që E..... t'ia rregullojë dy viza për E.... (E.Z) bashkëshorten dhe dy fëmijët tij. Për këtë E.... ka paguar 3000 (tremijë) euro po atë ditë, pastaj ia ka dhënë edhe fotografitë për pasaporta. Janë dakorduar që pjesën tjetër të parave t'i paguhet E....., kur këta të mbërrijnë në Angli.

Dëshmitari A.M në deklaratën në polici për këtë rrethanë ka deklaruar; “B..... ka kërkuar nga unë që të garantoj (për E.....) dhe paratë që nëse dështon marrëveshja unë t'ia kthejë paratë, mirëpo unë s'kam garantuar dhe i 'u kam thënë jo, për E..... po për kërkon nuk garantoj”.

Dëshmitari F.M në deklaratën në polici për këtë rrethanë pohon se palët janë takuar në restorantin e tij, pohon se B..... i ka kërkuar K..... (A.M) që të garantojë për vëllain e tij rreth marrëveshjes për disa viza.

Dëshmitari B.Ll në deklaratën në polici për këtë rrethanë ka deklaruar; “më 09.08.2006 dhëndëri imë E..... i ka dërguar 3000 euro, me ia dhënë E....., unë të hollat ia kam dorëzuar B....., prindit të E..... B..... me ka thënë se E..... më ka ma shumë borxh, për shpenzime të udhëtimit, gjykatave, kaucionit edhe shumë shpenzime tjera”.

- Lidhur me veprën penale dhe elemente e saj, sipas Kodit Penal të Kosovës kjo vepër penale përkufizohet kështu;

KONTRABANDIMI ME MIGRANTË

Neni 164

1. Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet.

2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon, furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të

udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë euro (500.000) dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Kushdo që i mundëson personit i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës të qëndrojë në Republikën e Kosovës ose personit i cili nuk është shtetas apo banor i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet nga paragrafi 2. i këtij neni ose me çfarëdo mjeteshe tjera të paligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni është e dënueshme.

5. Kushdo që organizon ose drejton personat e tjerë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet, ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.

6. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose në një mënyrë që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetërat apo sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor apo poshtërues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim jo më pak se pesë (5) vjet.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

Gjykata duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e theksuar në këtë aktgjykim, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri i ka ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat konsumojnë elementet e veprës penale; Kontrabandimi me migrantë, ashtu që;

- të dëmtuarve i 'u ka siguruar dokumente, pasaporta të falsifikuara me qëllim që t'i dërgojë jashtë Kosovës, për në shtetet tjera të perëndimt (Mbretërinë e Bashkuar), dhe pastaj;
- në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, ka organizuar transportin e të dëmtuarve, E..... dhe E.Z dhe dy fëmijëve të tyre nga një shtet në një shtet

tjetër, nga Kosova në Serbi, pastaj në Malin e Zi, drejt portit të Barit, për të udhëtuar në Itali e pastaj në Mbretërinë e Bashkuar.

- *i ka kaluar të dëmtuarit nga një shtet në një shtet tjetër në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me rregullat në fuqi për kalimin e ligjshëm kufitar, pasi që të dëmtuarit me dokumente-pasaporta të falsifikuara kanë kaluar në Malin e Zi, duke tentuar që të udhëtojnë nga porti i Barit në Malin e Zi, për në Itali dhe prej aty për në Angli.*
- *për të gjitha këto veprime të kundërligjshme, i pandehuri ka përfutuar dobi pasurore nga të dëmtuarit të cilët i kanë paguar të pandehurit një shumë të parave prej 3,000 €, ndërsa pjesën tjetër prej 5,000 €, janë dakorduar që të paguajnë pasi që të mbërrijnë në Angli.*

Gjykata nxjerr përfundimin se i pandehuri E.M është përgjegjës dhe fajtor për veprën penale; Kontrabandimi me migrantë sipas neni 164 par.1 e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

- Rikualifikimi i veprës penale;

Dispozitat relevante materiale dhe procedurale;

Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, sipas aktakuzë PP.nr.2/2008 e dt.02.01.2008 e ka akuzuar të pandehurin E.M për veprën penale; Kontrabandimi me migrantë nga neni 138 par.1 sipas Kodit Penal të Kosovës. Në rastin konkret, aktakuza është ngritur në vitin 2008, rrjedhimisht kualifikimi ligjor i veprës penale është bërë sipas ligjit që ka qenë në fuqi [Kodi Penal të Kosovës, UNMIK/Rreg/2003/25, 6 korrik 2003]. Mirëpo shqyrtimi gjyqësor dhe çështje penal është trajtuar, gjykuar si dhe ka përfunduar vetëm në mars të vitit 2022.

Nisur nga fakti se pas ngritjes së akuzës kundër të pandehurit, ka ndryshuar ligji, ashtu 14 janar 2019 është shpallur Kodi Penal i Republikës së Kosovës [Kodi nr. 06/1-074] në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, i cili hyn fuqi më dt.14.04.2019.

Bazuar në neni 3 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës [Kodi nr. 06/1-074], ku përcaktohet se: *“Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.*

Në rastin konkret, ligji (Kodi penal) ka ndryshuar para shpalljes së vendimit përfundimtar. Për më tepër, vepra penale për të cilin është ngarkuar i pandehuri sipas aktakuzës; Kontrabandimi me migrantë sipas neni 138 (1) parashihet dënim me burgim prej dy (2) deri në (12) dymbëdhjetë

vjet. Ndërkaq, sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës [Kodi nr. 06/1-074], që hyn në fuqi nga 14 prilli 2019, për veprën penal; Kontrabandim me migrantë sipas nenit 164 paragrafi 1 parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet. Mbi këtë bazë mund të përfundojmë se Kodi i ri penale është më i favorshme për të pandehurin, maksimumi i veçantë i dënimit që parashihet për këtë vepër penale është më i ulët, krahasuar me dënimin që parashihet për veprën penale për të cilën edhe akuzohet i pandehuri.

Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale. Kjo sipas nenit (360 par.2 të KPP).

Trupi gjykues duke u mbështetur në faktet dhe provat e procedurës në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar me ndërgjegje një nga një dhe në lidhshmëri me të gjitha provat tjera ka ardhur në përfundim se ndaj të pandehurit duhet zbatohet Kodi i ri penal sepse rezulton të jetë më i favorshëm në raport me dënimin. Andaj, veprën penale e ka ri kualifikuar si vijon; Kontrabandim me migrantë nga nenit 164 paragrafi 1 sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës [Kodi nr. 06/1-074].

Trupi gjykues në përshkrimin faktik nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale e as përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin apo të pandehurin, përveç disa rrethanave specifike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale.

Bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP dhe nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-ës, kjo Gjykatë ka ri kualifikuar veprën penale kundër të pandehurit duke aplikuar kodin penal më të favorshëm për të pandehurin, siç edhe u cek më lartë.

- Vlerësimi i provave;

Gjykata rithekson se gjatë shqyrtimit gjyqësor i dëmtuari E.Z nuk është dëgjuar si dëshmitar, sepse ka qenë e pamundur t'i dorëzohet thirrja për të marr pjesë në gjykim, krejt kjo në mungesë të adresës së të dëmtuarit. Në bazë të dëshmive të siguruar, rrjedhë se i njëjti nuk jeton që një kohë në Kosovë. Andaj, më 22 mars 2022 në seancën e shqyrtimit gjyqësor, sipas propozimit të prokurorit dhe në mbështetje të nenin 338 par.1 nën par 1.1 e 1.3 të KPP-së, Gjykata ka vendosur që ta lexoj deklaratën e të dëmtuarit që ka dhënë gjatë procedurës paraprake lidhur me këtë rast. Gjykata rikujton se deklaratat në fjalë, janë përdorur si provë e pranueshme duke marrë për bazë faktin se nuk kanë qenë si provë e vetme mbi të cilat mbështetet vendimi i gjykatës në raport me

fajësinë e të pandehurit. Ritheksojmë se, përveç dëshmisë së këtij dëshmitari janë marrë për bazë, vlerësuar dhe pranuar edhe dëshmitë e dëshmitarëve; A.I, B.Ll, F.M dhe A.M si dhe dëshmitë materiale, siç janë cekur në këtë aktgjykim.

Gjykata ka vlerësuar si të besueshme dëshminë e të dëmtuarit E.Z në raport me faktet kryesore. Për më tepër, dëshmia e tij mbështeten edhe ka përputhshmëri me prova tjera materiale dhe në dëshmitë e dëshmitarëve tjerë në këtë rast, prova këto të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilat dëshmojnë të njëjtën gjendje të cilën e pohon i dëmtuari. Për më tepër, nuk kemi vërejtur se i dëmtuari ka pasur ndonjë motiv të caktuar në deklaratimet e tij, në raport me të pandehurin. I dëmtuari nuk e njihte më parë të pandehurin, s'kishte asnjë problem apo mosmarrëveshje me të, si rrjedhojë nuk gjejmë se kishte ndonjë qëllim për të akuzuar pa të drejtë të pandehurin, siç mund të pretendohet nga palët. Gjykata ka kompetencë që të vendosë se çfarë vlere provuese ka një dëshmi e dëshmitarit apo se në çfarë niveli të besimit t'i jap asaj dëshmie. Kjo tagër e gjykatës buron në bazë të parimit për çmuarjen e lirë të provave, gjithmonë në raport edhe me të gjitha provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata nuk i ka kushtuar besimin deklaratës së dëshmitarit A.I që ka dhënë në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo i ka besuar deklaratës së tij që ka dhënë në polici për këtë rast. Gjykata ka vlerësuar se deklarata që ka dhënë dëshmitari në polici është e besueshme, pasi që kjo dëshmi për faktet kryesore përputhet plotësisht me dëshminë e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve tjerë. Për më tepër, dëshmia që ka dhënë në polici ka qenë më e freskët se ngjarjen e ka pas më të freskët dhe më lehtë e ka kujtuar. Ndërsa, dëshmia që ka dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk gjen asnjë mbështetje në asnjë dëshmi tjetër. Në anën tjetër dëshmitarit nuk i kujtohen shumë prej fakteve të rëndësishme, megjithatë dëshmitari nuk e ka mohuar se ka dhënë një deklaratë në polici, ka konfirmuar saktësinë e nënshkrimit të tij në atë deklaratë si dhe nuk e mohon përmbajtjen e deklaratës.

Gjykata i ka fal besimin deklaratave të dëshmitareve; R.K, A.M, F.M dhe B.Ll. Këto dëshmi janë pranuar si të besueshme pjesa që referohet në raport me faktet kryesore. Dëshmitë e tyre gjejnë mbështetje dhe përputhen njëra me tjetrën për saktësinë dhe përshkrimin e ngjarjes që lidhet me veprimet në këtë rast. Lidhur me ligjshmërinë e procedimit apo administrimit të këtyre dëshmimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme në faqen (5) pesë të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka pranuar dëshminë e dëshmitarit A.M, përkundër faktit se dëshmitari është vëllai i të pandehurit ai nuk është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar sepse i pandehuri ka qenë i akuzuar për veprën penale për të cilën parashihet dënimi me burgim deri në (10) dhjete vjet. Sipas nenit 127 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, dëshmitari nuk lirohet nga detyrimi për të dëshmuar. Megjithëse dëshmia e tij nuk ka qenë vendimtare për të përcaktuar përgjegjësinë penale për të pandehurin.

Më 28 janar 2022 në shqyrtimin gjyqësor, sipas propozimit të prokurorit dhe në mbështetje të nenit 338 par.1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penal [KPP], Gjykata ka vendosur që vetëm ta lexoj deklaratën e personit E.M. Gjykata në shqyrtimin gjyqësor nuk ka arrit të sigurojë prezencën tij, pasi është vërtetuar se i njëjti nuk jeton më (kanë ndërruar jetë). Përkundër faktit se deklarata e tij është lexuar në përputhje me dispozitat e KPP, si edhe u cekë më lart, kjo gjykata me rastin e marrjes së vendimit dhe arsyetimin e tij në asnjë rast dhe për asnjë moment nuk është mbështetur në deklaratën e këtij personi. Siç rezulton, shtetasi E.M më dt.11.10.2006 ka dhënë një deklaratë në polici në cilësinë e të dyshuarit. Pikërisht kjo është edhe arsye pse gjykata nuk është mbështetur në deklaratën e tij, sepse në këtë cilësi personi në fjalë nuk ka qenë i detyruar të flas të vërtetën. Për më tepër, në atë kohë kur E.M e ka dhënë këtë deklaratë ka pasur cilësinë e bashkëpandehurit dhe sipas nenit 126 par 1 nën paragrafi 1.3 te KPP, dhe dëshmia e tij në këtë cilësi nuk mund të merret si provë.

- Lidhur me vendimin për kthimin e dorëzanisë:

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, sipas aktvendimit P.nr.01/2008, i datës:04.02.2008, ka ndërprerë masën e paraburgimit ndaj të pandehurit E.M me dorëzani, duke aprovuar masën e dorëzani në shumë prej 7,000 (shtatë mijë) euro. Paratë janë deponuar përmes bankës NLB, më 04.02.2008. Vendimi mbi deponimin e dorëzanisë P.nr.01/2008, i datës:04.02.2008, është bërë i formës së prerë, sepse nuk është ushtruar ndonjë mjet juridik.

Sipas nenit 182 par.4 të KPP-ës, dorëzania hiqet vetëm kur të përfundoj procedura penale me aktgjykim apo aktvendim të formës së prerë.

Gjykata rikujton se më datën 22.03.2022, ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, ndërsa më datën 24.03.2022, është shpallur publikisht aktgjykimi, rrjedhimisht ka përfunduar proceduar penale kundër të pandehurit. Gjykata ka vendosur që në këtë aktgjykim

t'ia kthejë të pandehurit shumën e dorëzarisë, sepse i pandehuri për veprën penal që ka qenë i akuzuar është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim të kushtëzuar si dhe me gjobë. I pandehuri është përgjigjur në thirrjet e gjykatës si rrjedhojë ka filluar dhe përfunduar në tërësi çështja penale kundër tij. Gjykata bënë me dije se qëllimi i deponimit të shumës së dorëzarisë ka qenë sigurimi i prezencës së të pandehurit në procedurë, tani më ky qëllim është përmbushur sepse çështjen penale kundër të pandehurit ka përfunduar në shkallën e parë. Dorëzania kthehet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe vetëm pasi i pandehuri të ketë paguar dënimin me gjobë si në pikën II të këtij aktgjykimi.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin E.M ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar dashjen e të pandehurit (dashjen direkte si formën më të lartë të fajit), shkallën e përgjegjësisë penale (përgjegjësinë e plotë), kontributin e tij në këtë veprë penale, qëllimin e përfitimit, dëmin e shkaktuar të të dëmtuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese Gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte të treguar në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, se është i martuar, familjar, i punësuar dhe mbajtëse i familjes, nuk ka të dhëna se pas këtij rasti është marrë me aktivitet të njëjtë apo të ngjashëm se, nga koha e kryerjes së kësaj veprë penale kanë kaluar më tepër se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, më parë i pa dënuar, se pjesërisht i ka kompensuar të dëmtuarit, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë për veprë tjetër penale, që një kohë të gjatë jeton dhe punon në M.B(A) për të gjitha këto arsye Gjykata i ka shqiptuar dënim me burgim të kushtëzuar duke aplikuar rregullat për zbutjen e dënimit sipas nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPRK-ës, duke qenë të bindur se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësues të cilat janë numëruar më lartë por në veçanti, për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga kryeja e veprës penale e deri më tani, pikërisht për këto arsye ekzekutimi i dënimit me burgim nuk do të kishte asnjë efekt apo ndikim të i pandehuri përkundrazi do të krijoje efekt negativ pasi që i njëjti jeton dhe punon jashtë vendit dhe me të ardhurat që realizon e mban familjen e tij. Gjykata vlerëson se dënim i shqiptuar ndaj të pandehurit është adekuat, në raport me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat e tjera që kemi cekur, andaj jemi të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat tjerë, që të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë, Gjykata përveç rrethanave të lartë cekura ka vlerësuar dhe ka marr parasysh kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij. Siç edhe u theksua më sipër i pandehuri jeton dhe punon në A..., gjendja e tij ekonomike është e mirë. Në anën tjetër, i pandehuri ka deponuar shumën prej 7,000 euro në dorëzani, përveç tjerave edhe ky fakt tregon se gjendja dhe standardi i tij jetësor është shumë i mirë.

- Lidhur me llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar:

Gjykata duke u bazuar nënin 79 të KPK-së, sipas të cilës përcaktohet se masa e paraburgimi dhe çdo kufizim i lirisë duhet të llogaritet në dënimin e shqiptuar. Mbi këtë bazë, Gjykata kohën e kaluar nga i pandehurin në masën e paraburgimit i llogaritet në dënimin e shqiptuara kundër tij.

- Lidhur me kërkesën pasurore juridike;

Gjykata i ka udhëzuar të dëmtuarit që në kontest të rregullt civil të kërkojnë realizimin e të drejtës për të parashtruar kërkesën pasurore-juridike. Ky vendim është marr duke u mbështetur në nenin 463 par.3 të KPP-së, sepse të dëmtuarit nuk kanë prezantuar në seancë dhe për këtë arsye nuk kanë parashtruar kërkesën pasurore juridike.

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Gjykata e ka detyruar të pandehurin që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe këtë duke u mbështetur në nenin 453 paragrafi 1 sipas Kodit të Procedurës Penal të Kosovës.

Nga ajo që u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krimeve të Renda

P.nr.01/2008 dt.03.06.2022

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.